

## MARREVESHJE PER SHIT-BLERJEN E AKSIONEVE

KJO MARREVESHJE, lidhet sot me date 9 Tetor 2003, midis:

- **FONDIT SHQIPTARO-AMERIKAN TE NDERMARRJEVE**, organizate paqellim-fitimi, krijuar sipas legjislacionit te Shtetit Delaware, U.S.A, me seli ne USA dhe me zyre perfaqesimi ne. "Green Park" Complex, Kulla 2, Kati XII, Tirane, Shqiperi, perfaqesuar nga Z. Jeffrey T. Griffin, ne cilesine e Presidentit & CEO te AAF (me poshte i quajtur "Fondi");

Dhe


- **Z. SHYQYRI DURAKU**, shtetas shqiptar, lindur ne Kukes me 08.12.1954, mbajtes i pasaportes nr. 0608763, banues ne Rr.e Kavajes, No.58, Tirane;
- **Z. LLAZAR ANGJELI**, shtetas shqiptar, lindur ne Sarande, me 05.02.1940, mbajtes i pasaportes nr. 0085140, banues ne Rr. e Kavajes, No.24, H2/15, Tirane;
- **Z. AVNI PONARI**, shtetas shqiptar, lindur ne Tropoje, me 28/07/1957, mbajtes i pasaportes nr. 85115 banues ne TIRANE;
- **Z. EDVIN HOXHAJ**, shtetas shqiptar, lindur ne Lushnje, me 30.04.1966, mbajtes i pasaportes nr. 1247470, banues ne Rr. Irfan Tomini, Pallati No.4, Hyrja C/4, Tirane; (me poshte te quajtur "Aksionaret Ekzistues");

### MEQENESE

- (A) Aksionaret Ekzistues zoterojne te gjitha aksionet e kapitalit te shoqerise SIGURACIONI SHQIPTAR SHA. (SIGAL SHA.) (me poshte e quajtur "Shoqeria"), e cila eshte nje shoqeri anonime sigurimesh, e krijuar dhe qe zhvillon aktivitetin e licensuar rregullisht sipas legjislacionit te Republikes se Shqiperise, me kapital te nenshkruar dhe te shlyer teresisht nga Aksionaret Ekzistues ne shumen Leke 100.000.000 (njeqind million Leke), i ndare ne 33.333 aksione nga Leke 3.000 (tre mije Leke) secili (me poshte i quajtur "Kapitali"), me seli ne adresen: Bulevardi "Zogu I", Pallati i Diplomateve, No.57, Tirane.
- (B) Aksionaret Ekzistues zoterojne te gjitha aksionet e Kapitalit e Shoqerise ne raportet e meposhtme:

<u>AKSIONARET EKZISTUES</u>	<u>AKSIONET</u>
Z. Shyqyri Duraku	10.000 (30%)
Z. Lllazar Angjeli	10.000 (30%)
Z. Avni Ponari	11.000 (33%)
Z. Edvin Hoxhaj	2.333 (7%)
TOTAL	33.333 (100%)

- (C) Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise e mbajtur ne date 9 Tetor, 2003, ka vendosur te zmadhoje Kapitalin e Shoqerise duke emetuar aksione te reja ne dy faza: (i) Ne Fazen e Pare Shoqeria do te emetoje 4.546 (kater mije e peseqind e dyzet e gjashte) aksione te reja me vlere nominale Leke 3.000 (tre mije) secili. Te gjitha aksionet e emetuara ne Fazen e Pare do te nenshkruhen dhe shlyhen



me te holla ne dore nga Fondi, kundrejt shumes US\$ 1.500.000 (nje milione e peseqind mije dollare US), duke u bere aksionar i ri i Shoqerise. Kapitali i Shoqerise pas zmadhimit te Fazes se Pare do te jete Leke 113.636.363 (njeqind e trembedhjete million e gjashteqind e tridhjte e gjashte mije e treqind e gjashtedhjte e tre). Numri i aksioneve qe do te zoteroje Fondi (4.546 aksione) ("Aksionet e Fondit te Fazes se Pare") do te perbeje 12% te te gjithe Kapitalit te Shoqerise pas zmadhimit te kesaj faze. Numri i aksioneve qe do te zoterojne Aksionaret Ekzistues ne fund te Fazes se Pare do te mbetet i njejte me ate qe zoteronin perpara zmadhimit te Kapitalit; (ii) Ne Fazen e Dyte Shoqeria do te emetoje 53.670 (pese dhjete e tre mije e gjashteqind e shtatedhjte) aksione te reja me vlere nominale Leke 3.000 (tre mije) secili, qe do te nenshkruhen nga Aksionaret Ekzistues dhe Fondi ne raport me numrin e aksioneve qe do te zoterojne ne Kapitalin e Shoqerise ne fund te Fazes se Pare. Zmadhimi i Kapitalit dhe shlyerja e aksioneve te reja te emetuara nga Shoqeria ne Fazen e Dyte do te behet nepermjet perfshirjes se primit te emetimit te aksioneve te Fazes se Pare (diferenca midis shumes US\$ 1.500.000 qe Fondi do t'i paguaje Shoqerise ne Fazen e Pare dhe vleres se pergjithshme nominale te aksioneve te emetuara nga Shoqeria ne Fazen e Pare). Kapitali i Shoqerise pas zmadhimit te Fazes se Dyte do te jete Leke 274.645.000 (dyqind e shtatedhjte e kater million e gjashteqind e dyzet e pese mije). Numri i aksioneve qe do te zoteroje Fondi ne fund te Fazes se Dyte do te jete 10.987 aksione ("Aksionet e Fondit te Fazes se Dyte") dhe do te perbejne perseri 12% te te gjithe Kapitalit te Shoqerise pas zmadhimit te kesaj faze. Kurse Aksionaret Ekzistues do te zoterojne repsektivisht: Shyqyri Duraku, 24.168 aksione ose 26.40% te Kapitalit; Lllazar Angjeli, 24.168 aksione ose 26.40% te Kapitalit; Avni Ponari, 26.586 aksione ose 29.04% te Kapitalit; dhe Edvin Hoxhaj, 5.639 aksione ose 6.16% te Kapitalit. Marredheniet midis Fondit, Aksionareve Ekzistues dhe Shoqerise ne lidhje me zoterimin e aksioneve nga ana e Fondit jane rregulluar nepermjet Marreveshjes se Investimit te lidhur midis Fondit, Aksionareve Ekzistues dhe Shoqerise me date 9 Tetor 2003 ("Marreveshja e Investimit"), e cila, se bashku me Vendimin e Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionareve te Shoqerise, date 9 Tetor 2003, i bashkengjitet kesaj Marreveshje si pjese perberese e saj.

- (D) Asambleja e Jashtezakonshme e Aksionareve te Shoqerise, mbledhur ne daten 9 Tetor 2003, ka vendosur ndryshimet e neneve perkatese te statutit te Shoqerise sipas kerkesave te Fondit, si dhe ka vendosur te emeroje ne cilesine e Anetarit te Keshillit Mbikqyres te Shoqerise Z. Jeffrey T. Griffin, shtetas amerikan, lindur ne USA, me 14 Qershor 1944, mbajtes i pasaportes nr. 710333338, banues ne Shqiperi, Tirane, me kerkese te Fondit.
- (E) Aksionaret Ekzistues marrin persiper qe te blejne nga Fondi dhe Fondi merr persiper qe tu shese Aksionareve Ekzistues, te gjitha aksionet qe zoteron Fondi ne Kapitalin e Shoqerise, sipas kushteve dhe afateve te parashikuara me poshte.



3

DUKE PATUR PARASYSH KUSHTET E SIPERPERMENDUR, PALET BIEN DAKORT  
SI VIJON:

NENI I  
PERKUFIZIME

Termat e perdorura ne kete Marreveshje do te kene kuptimin e pershkruar me poshte nese nuk eshte parashikuar ndryshe apo nese nuk kane kuptim tjetër sipas kontekstit te perdorimit:

“Aksionet e Fondit” do te thote çdo dhe te gjitha aksionet e reja te emetuara nga Shoqeria sipas Vendimit te Asamblese se Jashtezakonshme te Aksionareve te Shoqerise date 9 Tetor 2003, ose ato te leshuara si rrjedhim i çdo pershtatjeje te mundshme te vleres se Kompanise per vitin 2002, qe mund te behet ne te ardhmen, te nenshkruara dhe shlyera nga Fondi sipas Marreveshjes se Investimit, date 9 Tetor 2003.

“Data e Dorezimit” do te thote data ne te cilen Njoftimi i Ushtrimit te se Drejtes se Shitjes ose te Blerjes se Aksioneve i dorezohet respektivisht Aksionareve Ekzistues nga Fondi ose Fondit nga Aksionaret Ekzistues.

“Njoftimi i Ushtrimit te se Drejtes se Shitjes” do te thote njoftimi i dorezuar Aksionareve Ekzistues nga Fondi sipas parashikimeve te Nenit 2.3, ne te cilin duhet te caktohen te pakten:


- (i) Numrin e Aksioneve te Fondit qe do t'i shiten Aksionareve Ekzistues nga Fondi;
- (ii) Çmimin e Shitjes, i cili do te caktohet ne Daten e Zbatimit ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshje;
- (iii) Daten e Zbatimit; dhe
- (iv) Vendin e Zbatimit.

“Afati i Ushtrimit te se Drejtes se Shitjes” do te thote periudha prej 3 (tre) vjetesh, e cila fillon nga viti 2006 dhe perfundon ne vitin 2008.

“Çmimi i Shitjes” ka kuptimin e percaktuar ne Nenin 3.1, i cili do te llogaritet dhe do te paguhet ne dollare amerikane.

“Njoftimi i Ushtrimit te se Drejtes se Blerjes” do te thote njoftimi i dorezuar Fondit nga Aksionaret Ekzistues sipas parashikimeve te Nenit 2.3, ne te cilin duhet te caktohen te pakten:

- (i) Numrin e Aksioneve te Fondit qe Aksionaret Ekzistues do te blejne nga Fondi;

: Si Arlens



 4

- (ii) Çmimin e Blerjes i cili do te caktohet ne Daten e Zbatimit ne perputhje me dispozitat e kesaj Marreveshje;
- (iii) Daten e Zbatimit; dhe
- (iv) Vendin e Zbatimit.

“Afati i Ushtrimit te se Drejtes se Blerjes”	do te thote periudha prej 2 (dy) vjetesh, e cila fillon nga viti 2007 dhe perfundon ne vitin 2008.
“Çmimi i Blerjes”	ka kuptimin e percaktuar ne Nenin 3.2, e cila do te llogaritet dhe paguhet ne dollare amerikane.
“Data e Pare e Zbatimit”	do te thote 30 dite pas dates se Dorezimit.
“Data e Dyte e Zbatimit”	do te thote 90 dite pas mbylljes se vitit financiar, ne te cilin u vendos per daten e Dorezimit
“Vendi i Zbatimit”	do te thote vendi ne Tirane, Shqiperi, siç percaktohet ne Njoftimin e Ushtrimit te se Drejtes se Shitjes ose te Blerjes qe do te jete vendi ne te cilin Aksionaret Ekzistues do t'i paguajne Fondit Çmimin e Shitjes ose te Blerjes se Aksioneve te Fondit.
“Aksionet”	do te thote aksionet e Kapitalit te Shoqerise.
“PBT”	do te thote fitimi perpara takses dhe shpenzimeve te jashtezakonshme

## NENI 2

### E DREJTA E SHITJES DHE E DREJTA E BLERJES SE AKSIONEVE

2.1 Fondi ka te drejte qe, ne çdo moment dhe here pas here, gjate Afatit te Ushtrimit te se Drejtes se Shitjes, nepermjet dorezimit te Njoftimit te Ushtrimit te Drejtes se Shitjes ne adrese te Aksionareve Ekzistues t'u shese atyre te gjitha ose nje pjese te Aksioneve te Fondit, qe zoterohen prej tij ne Kapitalin e Shoqerise ne Daten e Dorezimit te Njoftimit te Ushtrimit te Drejtes se Shitjes, kundrejt Çmimit te Shitjes te caktuar ne Daten e Zbatimit. E drejta e Fondit per te kerkuar nga Aksionaret Ekzistues qe te blejne Aksionet e Fondit me poshte do te quhet “E Drejta e Shitjes”. Me ushtrimin nga Fondi te kesaj te drejte, Aksionaret Ekzistues jane te detyruar, qe bashkerisht apo individualisht, te blejne te gjitha ose pjesen e Aksioneve te Fondit kundrejt Çmimit te Shitjes.

2.2 Aksionaret Ekzistues kane te drejte qe, ne çdo moment dhe here pas here gjate Afatit te Ushtrimit te se Drejtes se Blerjes, nepermjet dorezimit te Njoftimit te Ushtrimit te Drejtes se Blerjes ne adrese te Fondit te blejne nga Fondi te gjitha Aksionet qe Fondi zoteron ne Kapitalin e Shoqerise ne Daten e Dorezimit te Njoftimit te Ushtrimit te Drejtes se Blerjes, kundrejt Çmimit te Blerjes te caktuar ne Daten e Zbatimit. E drejta e Aksionareve

Ekzistues per te kerkuar nga Fondi qe t'u shese Aksionet e Fondit me poshte do te quhet "E Drejta e Blerjes". Me ushtrimin nga Aksionaret Ekzistues te kesaj te drejte, Fondi eshte i detyruar qe t'u shese Aksionareve Ekzistues te gjitha Aksionet e Fondit kundrejt Cmimit te Blerjes.

2.3 Njoftimi i Ushtrimit te se Drejtes se Blerjes dhe Pjeset perkatese te Fondit ("Pjeset Objekt Shitje") do t'i ofrohen secilit Aksionar ne proporcion me numrin e pjeseve qe zoteron ne kapitalin e Shoqerise. Ne rast se njeri nga Aksionaret Ekzistues, per çfaredo arsye, nuk blen pjeset korresponduese te Pjeseve Objekt Shitje ne ose para Dates se Zbatimit, ne Vendin e Zbatimit, atehere sipas rastit aksioneret e tjere jane te detyruar te blejne edhe Pjeset e mbetura te Fondit.

### NENI 3

#### ÇMIMI I SHITJES DHE ÇMIMI I BLERJES

3.1 Çmimi i Shitjes per Aksion, per te cilin Fondi dhe Aksionaret Ekzistues palet bien dakort nepermjet nenshkrimit te kesaj Marreveshje, do te jete i barabarte me shumen e percaktuar sipas formule se meposhtme dhe do te konsiderohet si çmim i drejte i caktuar midis shitesit dhe blesit ne nje kontrate te zakonshme shitje, dhe do te llogaritet sipas baze se meposhtme:

7.3 here PBT-ne e vitit, ne te cilin ekzekutohet e Drejta e Shitjes

3.2 Çmimi i Blerjes per Aksion, per te cilin Fondi dhe Aksionaret Ekzistues bien dakort nepermjet nenshkrimit te kesaj Marreveshje, do te jete i barabarte me shumen e percaktuar sipas formule se meposhtme dhe do te konsiderohet si çmim i drejte i caktuar midis shitesit dhe blesit ne nje kontrate te zakonshme shitje, dhe do te llogaritet sipas baze se meposhtme:

9.3 here PBT-ne e vitit, ne te cilin ekzekutohet e Drejta e Blerjes




3.3 (A) Ekzekutimi i pageses se Shitjes do te behet ne dy faza: 1) Fondi do te marre aksionet e tij proporcionalisht (llogaritur sipas aksioneve te tij ne Shoqeri si nje perqindje e shumes se pergjithshme te aksioneve te Shoqerise) me 7.3 here PBT-ne e vitit te meparshem fiskal deri ne Daten e Pare te Zbatimit dhe 2) Fondi do te marre diferencen e pageses sikunder eshte parashikuar ne Daten e Dyte te Zbatimit.

(B) Ekzekutimi i pageses se Blerjes do te behet ne dy faza: 1) Fondi do te marre aksionet e tij proporcionalisht (llogaritur sipas aksioneve te tij ne Shoqeri si nje perqindje e shumes se pergjithshme te aksioneve te Shoqerise) me 9.3 here PBT-ne e vitit te meparshem fiskal deri ne Daten e Pare te Zbatimit dhe 2) Fondi do te marre diferencen e pageses sikunder eshte parashikuar ne Daten e Dyte te Zbatimit.

### NENI 4

#### TRANSFERIMI I AKSIONEVE

4.1 Aksionaret Ekzistues ne Daten dhe Vendin perkates te Zbatimit, do te blejne numrin e Aksioneve te Fondit te percaktuar ne Njoftimin e Ushtrimit te se Drejtes se Shitjes ose te Blerjes dhe do te paguajne Çmimin e Shitjes ose te Blerjes, sipas rastit, ne fonde




menjehere te perdoreshme ne dollare US dhe Fondi do t'u dorezoje dokumentet e nenshkruara rregullisht te cilat jane te nevojshme per te transferuar Aksionet e Fondit te lira nga çdo barre apo e drejte e te treteve.

- 4.2 Nese te gjithë apo ndonje nga Aksionaret Ekzistues nuk i paguajne Fondit Çmimin e Shitjes apo te Blerjes, sipas rastit, ne nje shume te vetme branda Dates se Zbatimit, me kusht qe te njoftojne me shkrim Fonditn per pamundesine e tyre te pakten 10 dite nga Data e Zbatimit. Aksionari apo Aksionaret Ekzistues te cilet jane ne vonese do t'i paguajne Fondit Çmimin e Shitjes apo te Blerjes, sipas rastit, brenda nje afati 3 (tre) vjetesh dhe mbi shumen e papaguar te çmimit do te aplikohet nje interes 12% ne vit.
- 4.3 Çmimi i Blerjes nuk mund te financohet. Nese ndonje nga Aksionerat Ekzistues nuk mund te paguaje shumen perkatese brenda Datave te Zbatimit, atehere e Drejta e Blerjes do te konsiderohet absolutisht e pavlefshme.
- 4.4 Anetari i Keshillit Mbikqyres te Shoqerise, i caktuar nga Fondi, do te qendroje si i tille me te drejte vote ne Keshillin Mbikqyres, duke gezuar gjithë te drejtat, deri ne momentin qe Aksionaret Ekzistues t'i kene paguar Fondit te gjithë çmimin e Shitjes ose Blerjes sipas rastit, si dhe per çdo shume tjeter te pagueshme qe aplikohet sipas kushteve te kesaj Marreveshjeje ose Marreveshjes se Investimit.

#### NENI 5

#### TRANSFERIMI I TE DREJTAVE

- 5.1 Kjo Marreveshje do te jete detyruese dhe do te sjelle te drejta ne favor te pasuesve te paleve te kesaj Marreveshjeje ose personave, te cileve palet e kesaj Marreveshjeje u kane transferuar te drejta. Palet mund te transferojne keto te drejta plotesisht ose pjeserisht vetem me pelqimin paraprak me shkrim te Fondit.
- 5.2 Nese ndonje nga Aksionaret Ekzistues deshiron te shese apo te transferoje pjeserisht apo teresisht Aksionet e tij ne Kapitalin e Shoqerise tek te trete, ky Aksionar Ekzistues duhet te njoftoje me shkrim Fondin. Njoftimi duhet te permbaje te dhena ne lidhje me kushtet dhe afate e propozuara te shitjes, transferimit apo çdo forme tjeter disponimi te Aksioneve, personin e propozuar qe do t'i transferohen Aksionet, si dhe çdo te dhene tjeter qe mund te kerkoje Fondi me shkrim. Transferimi Aksioneve mund te behet dhe do te jete i vlefshem vetem me pelqimin paraprak me shkrim te Fondit.
- 5.3 Nese Aksionaret Ekzistues vendosin te shesin nje pjese ose te gjitha aksionet e tyre nje pale te trete, atehere Aksionaret Ekzistues nuk mund t'i shesin keto aksione pa ofruar te perfshijne ne kete shitje dhe me te njejtat kushte, te njejten shume ne perqindje te aksioneve te Fondit. Fondi nuk ka asnje detyrim per te pranuar oferten e bere nga Bleresi per te blere aksionet e Fondit.
- 5.4 Aksionari shites dhe Bleresi i propozuar, qe nuk eshte pale e kesaj Marreveshjeje, jane te detyruar te garantojne Fondin se kusht per transferimin e te drejtave dhe detyrimeve te

 Li Qilmi








Aksionarit shites, sipas kesaj Marreveshjeje, i transferohen Bleresit se bashku me Aksionet perkatese dhe do te kene fuqi detyruese edhe per te.

- 5.5 Pavaresisht nga sa parashikohet ne kete Marreveshje, Fondi, sipas zgjedhjes te tij dhe ne çdo kohe, mund te dale nga Shoqeria dhe t'u shese ose te disponoje ne favor te personave te trete aksionet e tij, pa pasur nevojte per miratimin e Aksionareve Ekzistues. Fondi bie dakord qe ne rast te daljes se tij nga Kompania sikurse permendur me sipër, atehere kjo blerje do tu ofrohet Aksionereve Ekzistues, ne menyre proporcionale, me te njejtat terma dhe kushte.

## NENI 6 TE NDRYSHME


- 6.1 Pa paragjykuar mjetet e tjera ne favor te Fondit sipas kesaj Marreveshje ose ndryshe, nese Aksionaret Ekzistues nuk kryejne pagesat perkatese perpara apo ne daten e percaktuar ne kete Marreveshje, do te paguajne 12% interes vonese ne dollare US, te caktuar ne menyre te arsyeshme nga Fondi te llogaritur nga Data e Zbatimit.
- 6.2 Me perjashtim te taksave dhe/ose tatimieve (nese ka te tille) qe zbatohet mbi fitimin qe do te realizoje Fondi (nese realizon nje te tille) per shkak te shitjes se Aksioneve te Fondit sipas kesaj Marreveshje, i cili duhet te paguhet nga Fondi, Aksionaret Ekzistues marrin persiper qe te paguajne çdo takse dhe/ose tatim (perfshire edhe taksen e pulles), detyrime apo shuma te tjera te pagueshme ne lidhje me nenshkrimin, dorezimin, zbatimin, regjistrimin apo noterizimin e kesaj Marreveshje ose shitjen ose transferimin e Aksioneve te Fondit ne favor te Aksionareve Ekzistues, ose ne lidhje me çdo dokument tjeter ne lidhje me te: dhe do te rimbursojne Fondin ne lidhje me keto shpenzime.
- 6.3 Aksionaret Ekzistues nuk do te ndermarrin e as do te mbeshtesin veprime (si aksionare te Shoqerise), objekt i te cileve eshte pengimi apo ndalimi i shitjes, transferimit, apo disponimit te Aksioneve nga ana e Fondit.
- 6.4 Çdo njoftim apo komunikim sipas kesaj Marreveshje duhet te behet me shkirm dhe te dergohet nepermjet (i) postes rekomande me pergjigje te marresit ne adresen te pales se ciles i behet njoftimi, (ii) postes ekspres, ose (iii) duke ia dorezuar pdorazi personit. Njoftimi do te konsiderohet i marre ne daten ne te cilen eshte dorezuar dorazi ose ditën e dyte te punes pas dites se nisjes me poste ekspres. Nese njoftimi dergohet me poste rekomande, ai do te konsiderohet se eshte marre ditën e trete te punes nga data ne te cilen eshte postuar. Per qellim njoftimi, adresat e paleve do te jene ato qe tregohen ne fillimin e kesaj Marreveshje.
- 6.5 Kjo Marreveshje ka fuqi ligjore per palet dhe pasuesit e tyre. Asnje nga palet e kesaj Marreveshje nuk ka te drejte qe t'i kaloje apo transferoje ne çfaredo menyre te gjitha apo nje pjese te te drejtave dhe detyrimeve qe rrjedhin per to sipas kesaj Marreveshje, pa miratimin paraprak te paleve te tjera.



6.6 Kjo Marreveshje dhe te drejtat e detyrimet e paleve do te rregullohen, interpretohen dhe ekzekutohen ne perputhje me legjismacionin e Republikes se Shqiperise dhe te gjitha konfliktet do t'i paraqiten per zgjidhje Gjykates se Shkalles se Pare Tirane.


NE PRANI TE NJERI TJETRIT, palet nenshkruajne kete Marreveshje ne pese origjinale ne gjuhen angleze e pese ne gjuhen shqipe me vlere te njejte secila, sot me date 9 Tetor 2003.

**FONDI SHQIPTARO-AMERIKAN I NDERMARRJEVE**


Nga:   
Emri: Jeffrey T. Griffin  
Titulli: President dhe CEO

F O N D I  
SHQIPTARO AMERIKAN  
I NDERMARRJEVE  
TIRANE ALBANIA


**Z. SHYQYRI DURAKU**




**Z. LLAZAR ANGJELI**



**Z. AVNI PONARI**

  
SIGURIMET SHQIPTAR  
DIREKTORIA PËR QENDRIMET  
HEAD OFFICE

**Z. EDVIN HOXHAIJ**





MINISTRIA E JUSTICIAJ  
TIRANE